



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:177534

Datë: 01.09.2021

Numri i dokumentit: 02134606

P.nr.1000/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të akuzuarit Z...A,,, nga fshati Ll..., Komuna e N..., për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.2100/2020, të datës 15.12.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik me datë 26.07.2021 mori dhe shpalli ndërsa me datë 01.09.2021 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari Z...A... nga babai I... dhe nëna T... e lindur S..., i lindur me datë ...në fshatin Ll..., Komuna e N..., ku edhe jeton, ka të kryer shkollën mesme, i martuar, baba i 3 fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, përfitues i ndihmës sociale me numër..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë 21.11.2020, rreth orës 14:50 minuta në territorin e fshatit B..., Komuna e Gjilanit, në pronën shtetërore, në vendin e quajtur ‘...’ me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete, ka vjedhur dru në atë mënyrë që me sharrë motorike ka prerë .. copa dru të llojit bung, me diametër në cung ...cm, në lartësi të drurit .. cm dhe gjatësi6 m, me vëllim të përgjithshëm prej ...m3, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e veta të dëmtuarës APK në Gjilan i kanë shkaktuar dëm material në vlerë të papërcaktuar.

-Me çka ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-ës.

Andaj, në bazë të neneve 4,38,39,46,47,48,49,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 326 dhe 365 të KPP-ës të akuzuarin Z..A...:

E GJYKON

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale.

E dëmtuara ...për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Gjykata duke u bazuar në nenin 453 paragrafi 4 i KPP-ës, ka vendosur që të pandehurin ta lirojë nga të gjitha shpenzimet e procedurës penale.

## ARSYETIM

### 1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm me datë 15.12.2020 ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.2100/2020 kundër të pandehurit..., Komuna e Novobërdës për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-ës.

Më datë 26.07.2021 është mbajtur seanca e shqyrtimit gjyqësor në të cilën seancën kanë prezantuar prokurori i shtetit dhe i pandehuri i cili ishte sjellur nga ana e Policisë së Kosovës meqenëse për të njejtin paraprakisht ishte lëshuar urdhërarrest me ç'rast pas leximit të aktit akuzues nga prokurori i shtetit i pandehuri kishte deklaruar se e kishte kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e saj, pranim ky i cili nuk ishte kundërshtuar nga ana e palëve prezente dhe rrjedhimisht ishte pranuar me aktvendim procedural nga ana e gjykatës në kuptim të nenit 326 të KPP-ës dhe më pas seanca e shqyrtimit gjyqësor kishte vazhduar me fjalët përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse në seancën e shqyrtimit të gjyqësor i akuzuari ka pranuar për veprën penale të cilat i vihet në barrë dhe se ky pranim i fajësisë është i mbështetur në provat tjera materiale bashkangjitur aktit akuzues, fakte këto dhe prova në bazë të të cilave në mënyrë të pa kontestueshme argumentohet fakti se tani i akuzuari ka kryer veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të kësaj aktakuze, për çka edhe mbetet pranë saj dhe propozimeve të cilat e njëjta përmban andaj edhe ka kërkuar nga gjykata që komfor dispozitave ligjore të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit ndërsa sa i përket caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka propozuar që gjykata të merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese me qëllim që dënimi të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë e veprës penale.

I akuzuari Z... A....në fjalën përfundimtare ka deklaruar kërkon falje për veprimet e tija, e ka njoftuar gjykatën se këto veprime i ka bërë për shkak të gjendjes së varfër ekonomike ngase është mbajtës i familjes 5 anëtarëshe, i papunë dhe se e gjithë familja nuk gëzojnë të ardhura përpos asistencës nga ndihma sociale që e merr i njejtë dhe njëkohësisht i njejtë ka premtuar që në të ardhmen nuk do të përsërisë veprën penale dhe ka kërkuar nga gjykata një dënim sa më të butë.

### 2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në të cilin kanë qenë prezente palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të akuzuarit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 326 të KPP-ës paragrafi 1 lidhur me nenin 248 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza po ashtu me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

### 3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: i akuzuari Z... A.. nga fshati Ll..., Komuna e N... ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-ës në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### 4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të akuzuarit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës ashtu që gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit e cila nga provat materiale në shkresat e lëndës del të jetë e lartë meqenëse i akuzuari me rastin e kryerjes së veprës penale ka qenë i përgjegjshëm për veprimet e tija, me rastin e caktimit të dënimit gjykata pati parasysh edhe rrethanat personale të kryesit për faktin se i njëjti është familjar, mbajtës i familje dhe atë se për të ishte hera e parë që i njëjti bie ndesh me ligjin.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh edhe rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjykata mori faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihej në barrë, i njëjti është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tij, ka kërkuar falje për këto veprime, faktin se i njëjti ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarin gjykata mori shkallën e lartë të dashjes të shfaqur nga ana e të akuzuarit sepse nga përshkrimi faktik si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës del i akuzuari këtë vepër penale e ka kryer me dashje dhe atë direkte andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës gjykata të akuzuarit ia shqiptoj dënimin brenda kufijve të paraparë ligjor të paraparë si në nenin 72 të KPRK-ës gjithnjë duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

### 5. Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike

Duke pasur parasysh se në dispozitivin e aktakuzës lëndore është cekur vlera e dëmit mirëpo lidhur me llogaritjen e këtij dëmi nuk ka ndonjë ekspertizë të veçantë por e njëjta është bërë në bazë të kalkulimit të bërë nga vet e dëmtuara gjykata konsideron se e njëjta nuk ofron bazë të mjaftueshme për gjykimin e plotë e as të pjesërishtë të kërkesës pasurore juridike andaj edhe bazuar në nenin 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës të dëmtuarën APK për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

### 6.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata duke u bazuar në nenin 453 paragrafi 4 i KPP-ës, ka vendosur që të pandehurin ta lirojë nga të gjitha shpenzimet e procedurës penale ngase duke u bazuar në gjendjen e tij ekonomike përkatësisht faktin se i njëjti është i gjendjes së varfër ekonomike fakt ky i cili vërtetohet edhe nga kartela e ndihmës sociale me numër 333905 gjykata erdhi në përfundimin se pagimi i shpenzimeve procedurale do të rrezikonte gjendjen e tij edhe ashtu të rënduar materiale e po ashtu edhe të anëtarëve të tjerë të familjes për të cilët i njëjti detyrohet që ti mbështes materialisht.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.1000/2020, me datë 01.09.2021

Zyrtarja Ligjore,  
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Rilind Sermahaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjiilan.